




PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2026

LËNDA GJEOGRAFI





TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE.....	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK- UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	10
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	11
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS.....	11



HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës së gjeografisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit të gjeografisë. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MA-ja ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve.
- b) Programe lëndore të gjeografisë.
- c) Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënien e lëndës së gjeografisë.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore e lëndës së gjeografisë sipas programeve lëndore përkatëse.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MA-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës së gjeografisë është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të kandidatëve. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së gjeografisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese. Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë, nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të gjeografisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së gjeografisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme: <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e

- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MA-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.	punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	---

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjeografisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe të aftësive të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të gjeografisë); - shpjegon lidhjen program - tekst nxënësi; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për	- Korniza kurrikulare, 2014 https://www.ascap.edu.al/korniza-kurrikulare/ - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. https://www.ascap.edu.al/kurrikula-berthame-per-arsimin-e-mesem-te-ulet/ - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016 https://www.ascap.edu.al/kurrikula-berthame-x-xii/ - Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca klasat VI,VII,VIII, IX dhe klasat X,XI, XII. https://www.ascap.edu.al/arsimi-baze/

të realizuar përmbushjen e kompetencave; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjeografisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.	
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I	
“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjeografisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar të nxëni; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një testi. - ndërton pyetje që vlerësojnë rezultatet e të nxënit;	- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. https://www.ascap.edu.al/korniza-e-vleresimit-te-nxenesit-ne-arsimin-parauniversitar/ - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-amu-2017/ - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-gjimnazin/ - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018. https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-kurrikulen-me-zgjedhje-ne-gjimnaz/ - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë.

- shpjegon strategji që përdoren në orët e punëve praktike në lëndën e gjeografisë; - evidenton teknika dhe metoda që përdoren në veprimtaritë praktike dhe punën me hartën gjeografike. - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	(Material shpjegues në ndihmë të shkollave), nëntor 2018. https://www.ascap.edu.al/vleresimi-i-nxenesit-ne-amu-dhe-aml/
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e gjeografisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të nxënësit; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një testi.	- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (Material shpjegues në ndihmë të shkollave), shtator 2019. - Udhëzues kurrikular lëndor për gjeografinë AMU, dhjetor 2018. https://www.ascap.edu.al/nivelet-e-arritjes/ https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-kurrikulen-me-zgjedhje-ne-gjimnaz/ https://www.ascap.edu.al/vleresimi-i-nxenesit-ne-amu-dhe-aml/ https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendore/

	- Udhëzues kurrikular lëndor për gjeografinë AML, dhjetor 2018. https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendore/ - Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), Lënda: gjeografi. https://www.ascap.edu.al/model-e-testesh/
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në gjeografi”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - prezanton materiale dhe informacione duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Excel, Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime në gjeografi duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së gjeografisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website.	- Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/10/FINAL-12.04.2021-Redaktuar-Standardet-profesionale-te-mesuesit-per-perdorimin-e-TIK-ut.pdf - Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021 https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2021/06/User-Guide.pdf - Materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së gjeografisë që kanë në fokus

	përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie.
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së gjeografisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e gjeografisë në klasat 1-9 dhe në klasat 10-12; - shpjegon konceptet kryesore me të cilat operon lënda e gjeografisë; - interpreton lidhjet shkak-pasojë midis proceseve e dukurive që trajton kjo lëndë; - demonstroi lidhjen midis njohurive të lëndës me njohuritë e disiplinave të tjera brenda fushës ose jashtë saj;	- Programe dhe tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës së gjeografisë për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

- tregon përmes shembujve lidhjen e njohurive të kësaj lënde me situata të jetës së përditshme.	
--	--

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al